



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 717/24 Dt. 20.11.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2, neni 14 paragrafi 1 të Rregullores Komunale, nr. 001-011-201 datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-030 nr.150029, të datës 13.11.2024 të Këshillit Organizativ, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa 01-030 nr.150029, të datës 13.11.2024 e Këshillit Organizativ, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve rreth organizimit dhe mbajtjes së tubimit (manifestim kulturor) kushtuar Rrokut prizrenas dhe më gjerë, që do të mbahet me datë 23.11.2024 në Sallën e Librarisë “Altera” në Prizren, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve të këtij manifestimi, lejohen mjetet financiare në shumën prej 700 € (shtatëqind euro).
2. Ky manifestim i cekur si në pikën 1 të këtij vendimi, organizohet nga ana e Këshillit Organizativ në përbërje si në vijim: Agim Tejeci, Ambroz Tomrecaj dhe Sylejman Krasniqi.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
4. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Këshillit Organizativ,
 - Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Arkivës së Kryetarit.

